

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË BAJRAM CURRI

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Bajram Curri, me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, vlerësimin për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimin e policisë bashkiake, vlerësimi i auditit të brendshëm, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 14, datë 3.02.2012 .

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 290/8, datë 3.02.2012, dërguar z. **Agron Demushi**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga ana e Zyrës së Financës të kërkohet dokumentimi në magazinën e institucionit i “Projekt preventivitet të ngrohjes të Pallatit të Sportit” likuiduar subjektit “K” Tropojë, me urdhër shpenzimit nr. 124, datë 02.04.2010 në vlerën 399.800 lekë.

Menjëherë

2. Nga ana e Zyrës së Financës të kërkohet dokumentimi në magazinën e institucionit “Projekt preventivi i Ujësjiellit të qytetit Bajram Curri” likuiduar subjektit ■ Tiranë, me urdhër shpenzimit nr. 305, datë 03.08.2010 në vlerën 399.800 lekë.

Menjëherë

3. Nga ana e Zyrës së Financës të kërkohet dokumentimi në magazinën e institucionit dhe të kryhet sistemimi kontabël i sasisë prej 88 litra naftë likuiduar subjektit ■ Tropojë, me urdhër shpenzimit nr. 208, datë 15.06.2011 në vlerën 15.000 lekë.

Menjëherë

4. Për rakordimin e inventarit fizik të mjeteve të transportit me kontabilitetin të kryhet sistemimi kontabël nga zyra e financës duke e pasqyruar si debitor dhe nga institucioni të kërkohet përgjegjësia për moskthimin në institucion të autoveturës Benz me targë TR 5091 B pronë e Bashkisë përvetësuar nga ish punonjësi i bashkisë njëkohësisht drejtues i mjetit ■ në fillim të vitit 2006, ndërkohë të bëhet edhe kallëzim penal duke kërkuar zhdëmtimin e vlerës së mjetit.

Menjëherë

5. Për rakordimin e inventarit fizik të mjeteve të transportit me kontabilitetin të kryhet sistemimi kontabël nga zyra e financës duke e pasqyruar si debitor dhe nga institucioni të kërkohet përgjegjësia për moskthimin në institucion të mjetit Tip. Zetor me goma TK 82 me Targë BC - 0039 Z ,pronë e bashkisë përvetësuar nga drejtues i mjetit ■ që në fillim të vitit 2006, ndërkohë të bëhet edhe kallëzim penal duke kërkuar zhdëmtimin e vlerës së mjetit.

Menjëherë

6. Për dhënien me qira të ambienteve, nga ana e institucionit të evidentohen të gjitha asetet pronë publike e Bashkisë që mund të jepen me qira, të pajisen me genplanin përkatës dhe pasi të ketë vendosur këshilli bashkiak për dhënien me qira dhe nivelin e saj për m² të çdo ambienti, të lidhet kontrata me qiramarrësin duke përcaktuar qartë detyrimet e ndërsjella dhe sanksionet si dhe

detyrimet për energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm, siç përcaktohet në VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore” ndryshuar me VKM nr. 739, datë 01.07.2009.

Menjëherë

7. Për mos zbatimin me cilësi të punimeve sipas kontratës sipërmarrjes për punë publike datë 26.08.2010, t’i kërkohet operatorit ekonomik [REDAKTUAR] përfaqësuar nga z. B. B., që të përsëriten punimet në objektin “Riparim asfalti në shëtitoren kryesore të qytetit Bajram Curri”, në të kundërtën të kërkohet në rrugë gjyqësore kthimi i vlerës së punimeve prej 1.063.230 lekë pa t.v.sh.

Menjëherë

8. Pas një inventarizimi të hollësishëm mbi gjendjen aktuale të shërbimit të pastrimit dhe gjelbërimit të qytetit dhe mundësive reale për përmirësimin e gjendjes ekzistuese nga administrata e bashkisë, ti propozohet këshillit bashkiak që të vendosë për kryerjen nga vetë bashkia ose dhënien në sipërmarrje të këtyre shërbimeve publike.

Menjëherë

9. Nga zyra e taksave vendore të bëhet rakordimi i mjeteve të transportit, duke hartuar një inventar të plotë të mjeteve në pronësi të qytetarëve sipas llojit të tyre dhe tonazhit, si përcaktohet në udhëzimin e përbashkët të MPVD dhe Ministrisë së Financave nr. 9, datë 04.02.2003 “Për regjistrimin e përvitshëm të mjeteve të transportit”.

Menjëherë

10. Nga ana e zyrës së taksave vendore të hartohen planet vjetore për ushtrimin e kontrolleve në drejtimet e përcaktuara në pikën 10 “Kontrolli tatimor”, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore” .

Vazhdimisht

11. Korrespondenca ndërmjet zyrës së taksave vendore dhe Policisë së Bashkisë të bëhet zyrtarisht nëpërmjet protokollit.

Menjëherë

12. Policia Bashkiake të hartojë planin e kontrollit vjetor dhe të marrë masat që procedurat e punës të dokumentohen në mënyre shkresore, duke u bazuar në kërkesat e Kreut VII-të urdhrin të përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrisë së Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të komunës”.

Menjëherë

13. Nga ana e Policisë bashkiake në bashkëpunim me Zyrën e taksave të hartohet paketa me llojet dhe masën e gjobës dhe t’i kërkohet këshillit bashkiak, të vendosë për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10.279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”

Në mbledhjen e radhës

14. Nga Inspektoriati Ndërtimor i Bashkisë, të hartohet plani vjetor për ushtrimin e kontrolleve në drejtimet e përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” dhe neneve 3, 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime.

Vazhdimisht

15. Nga Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik të ushtrohen kontrolle të vazhdueshme për ndërtimet pa leje dhe në se konstatohen të tilla, të paraqesë pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale të shoqërisë apo të personave përgjegjës. Në rastet e ndërtimeve pa leje, të vendosë prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm dhe të përgatisë kallëzimin penal në prokurori.

Menjëherë

16. Të plotësohen Dosjet e Personelit me dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në Aneksin I dhe II të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 "Për organizimin e dosjes dhe Regjistrin të Personelit"

Menjëherë

17. Të bëhet azhurnimi periodik në librin e llogarive personale si dhe në Regjistrin Themeltar të Punonjësve .

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT

Të kërkohet në rrugë ligjore vlera **8.770.800 lekë**, nga të cilat:

1. **Vlera 43.854 lekë**, e cila përfaqëson pagesën padrejtësisht për punë jashtë kohës normale të 5 (pesë) punonjësve, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar me VKM nr. 328, datë 31.05.2006.

Menjëherë

2. **Vlera 11.527 lekë**, nga ■ ish kryetar i Bashkisë Bajram Curri, e cila përfaqëson vlerën e tejkalimit të shpenzimeve të telefonisë celulare trajtuar në pikën 3.2 "Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës në kundërshtim me VKM nr. 343, datë 11.07.2002" Për pajisjen numër celulari të punonjësve të administratës publike".

Menjëherë

3. **Vlera 110.240 lekë** e cila përfaqëson pagesën padrejtësisht të shpenzimeve për pritje e përcjellje në tre raste, kryer me urdhër të ish titullarit nga komisioni i prokurimeve të blerjeve në vlera të vogla, sipas urdhër shpenzimit nr. 498 datë 18.12.2009 në vlerën 37.760 lekë, nr. 234, datë 01.06.2010 në vlerën 24.500 lekë dhe nr. 253, datë 01.06.2010 në vlerën 47.980 lekë, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 243, datë 15.05.1995 ndryshuar me VKM nr. 258, datë 03.06.1999 "Për shpenzimet për pritje e përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja" ngarkohen me përgjegjësi solidare 5 punonjësit përkatësisht: ■ 22.050 lekë, ■ 22.050 lekë, ■ 22.050 lekë dhe ■ 22.050 lekë.

Menjëherë

4. **Vlera 239.760 lekë**, nga subjekti fizik ■ i regjistruar në organin tatimor me kod fiskal nr. ■ për mos zbatim të afatit të dorëzimit të makinës tip "Tojota 105 XL Land-Cruiser" (Foirustradë), brenda 1 muaji, sipas kontratës nr.04, datë 15.10.2009 pasi autovetura duhej dorëzuar brenda datës 14.11.2009. Për shkelje të kushteve standart të tenderit, bazuar në nenin 34 dhe 34.1 : "Dëmet e likuidueshme për vonesën në pëmbushjen e kontratës" të DST tarifa ditore është 4/1000 e vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë nga ku rezulton se subjekti fizik ■ duhet të ngarkohet me sanksione sipas përllogaritjeve në vlerën 239.760 lekë (vlera e kontratës 4.122.009 prej 2.997.000 lekë x 4/1000 = 11.988 lekë në ditë x 20 ditë vonesa = 239.760 lekë.)

Menjëherë

5. **Vlera 114.424 lekë, nga operatori ekonomik** [REDACTED] e cila përfaqëson vlerën 50.630 lekë punime të pa kryera në objektin “Riparim asfalti në shetitoren kryesore të qytetit Bajram Curri” dhe vlerën 63.794 lekë “garanci e defekteve të punimeve për një periudhë prej 24 muaj” sipas pikës 11.1 paragrafi II i kontratës të sipërmarrjes datë 26.08.2010.

Menjëherë

6. **Vlera 302.324 lekë**, e cila përfaqëson detyrimin e përlogaritjes padrejtësisht më pak të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit si rezultat i mos përfshirjes të vlerës së TVSH në preventiv në **21 raste** dhe konkretisht: për vitin 2009 në 6 raste në vlerën 106.104 lekë, për vitin 2010 në 13 raste në vlerën 184.301 lekë dhe për 6 mujorin e parë të vitit 2011 në 2 raste në vlerën 11.919 lekë, në kundërshtim me kreun II të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”. sipas listës trajtuar në pikën V (të raportit përfundimtar të kontrollit) “Kontroll në fushën e urbanistikës”, pika 5 “Kontroll mbi detyrimet financiare për marrjen e lejeve të ndërtimit”

Menjëherë

7. **Vlera 7.948.671 lekë, nga shoqëria** [REDACTED] që përfaqëson:

- Vlerën 763.890 lekë, punime të pakryera në objekt deri më 26.01.2012.

- Vlerën 7.184.781 lekë, sanksione për mos përfundimin në afat të punimeve, sipas kontratës datë 20.06.2008, të lidhur ndërmjet [REDACTED] dhe bashkisë Bajram Curri.

Nga vlera e kontratës datë 20.06.2008 prej 28.739.124 lekë me t.v.sh. $x 4 = 114.956.496 : 1000 = 114.956$ lekë kamat vonesë në ditë, është tejkualuar afati për 1.121 ditë $x 114.956$ lekë/ditë = 128.865.676 lekë, e cila kalon vlerën e kontratës, ndërkohë që sanksioni nuk mund të kalojë 25 % të kontratës, pra sanksioni me të cilën do të ngarkohet shoqëria [REDACTED] mbetet **7.184.781** lekë. (28.739.124 vlera e kontratës $x 25 \%$)

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës”, ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Bajram Curri, [REDACTED] që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. “Zgjidhje e marrëdhënieve të punës”, për punonjësën si më poshtë:

1. [REDACTED] **Inspektori i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik.**

Për shkeljet e mëposhtme:

a) Nga ana e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Bajram Curri, nuk janë ushtruar kontrole në zbatim ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” dhe konkretisht të nenit 5 në drejtimet e **mëposhtme;**

-nuk ka ushtruar kontrole për zbatimin e kushteve teknike në ndërtim.

-nuk ka ushtruar kontrole për objektet që ka dhënë Lejë ndërtimi KRT e Bashkisë Bajram Curri, në drejtim të mbajtjes akteve të piketimit, akti i përfundimit të themeleve, akti i përfundimit të karabinasë.

-nuk ka ushtruar kontrole në drejtim të marrjes së masave të sigurimit teknik dhe mjetet mbrojtëse të jetës së puntorëve, krijimit të kushteve sipas Kodit Punës.

-nuk ka vendosur asnjë gjobë në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, siç përcaktohet në nenin 81“Sanksionet” të ligjit “Për Urbanistikën” ndonëse janë konstatuar ndërtime pa lejë si, objekte, mure, shtesa, bllokim rruge etj, duke mos zbatuar edhe pikën 8 të Vendimit të Këshillit Ministrave nr.862 datë 05.12.2007”Për unifikimin e procedurave të kontrollit të teritorit nga inspektoriat ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai Vendor”.

-nuk janë ushtruar kontrole për vendosjen e mbikëqyrësve të punimeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve, neni 7 të ligjit nr. 8402,datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit“, me ndryshime.

-nga ana e Inspektoratit ndërtimor urbanistik ndaj subjekteve ndërtuese të cilët nuk kanë njoftuar për fillimin e punimeve, nuk janë ndëshkuar me gjobë, siç përcaktohet në ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, KREU IV SANKSIONET, neni 15,(Paragrafi ndryshuar me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007)

-për mos dorëzimin në zyrën e arkivit të Dosjeve të Inspektoriatit ndërtimor urbanistik,në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Rregullores së Brendshme të bashkisë Bajram Curri.

Mbështetur në nenin 25 shkronja, (a), (b) , të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 ”Statusi i nëpunësit Civil”, VKM, nr.306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil” dhe nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Bajram Curri, ■■■. që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

b- **“Vërejtje me Shkrim”**, për 5 (Pesë) punonjësit e mëposhtëm:
■■■ me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Financës .

Për shkeljet e mëposhtme:

-për nxjerrjen e pa saktë të Pasqyrave Financiare (bilancit kontabël vjetor 2009 dhe 2010) dhe pa u mbështetur në dokumentacionin përkatës si Ditarë,Fletë hyrje,Fletë Dalje,inventarë fizike, në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I, ”Mbajtja e kontabilitetit”,pika 2 shkronja (c),”Dokumentet e kontabilitetit”, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”.

-nuk është zbatuar Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen e dhe raportimin e pasqyrave financiare Vjetore të vitit 2007 për institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njërive që varen prej tyre si dhe të njërive të menaxhim zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të huaj”, pasi Përgjegjësja e Zyrës së Financës ka përgatitur Bilancin kontabël, por këto nuk janë rakorduar me inventarin fizik dhe konkretisht në rastin e tre mjeteve të transportit dhe karburantit.

-për kryerjen e pagesave të padrejta për punë jashtë kohës normale të punës në 5 raste për vlerën 43.854 lekë.

-për kryerjen e shpenzimeve tej limit të përcaktuar në 4 raste për vlerën 11.527 lekë të telefonisë celulare.

- për pagesat e padrejta të kryera për shpenzime pritje e përcjellje në tre raste për vlerën 110.240 lekë.

- për kryerjen e pagesës të situacionit përfundimtar të punimeve të objektit “Riparim asfalti në shëtitoren kryesore të qytetit Bajram Curri” për llogari të sipërmarrësit “V” pa ndaluar garancinë e punimeve në vlerën 63.793 lekë, likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 397 datë 03.11.2010.
- për mos administrimin si duhet të aseteve pronë publike e bashkisë dhe mos arkëtimin e qirasë së ambienteve dhënë në përdorim personave të ndryshëm.
- për likuidimin me urdhër shpenzimit nr. 497 datë 17.12.2010 të situacionit përfundimtar të punimeve të objektit “Adoptim i shtëpisë së ushtarakëve për konvikt të shkollës së mesme” për llogari të sipërmarrësit “I. C.” në një kohë që me datë 26.01.2012 nuk janë kryer punimet në vlerën 763.890 lekë.
- ka lejuar që për 2 vitet 2009-2010, të tejkalohet limiti i blerjeve të vogla prej 480.000 lekë , duke prokuruar të njëjtin artikull brenda vitit në 7 raste për vlerën **2.667.975 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ndryshime, Kreu VI,-të “ZHVILLIMI I PROCEDURËS SË KËRKESËS PËR PROPOZIME,PROKURIM ME VLERË TË VOGËL”, pika 2.

2. ■■■ me detyrë përgjegjëse zyrës së taksave vendore.

Për shkeljet ligjore të mëposhtme:

- nuk ka ushtruar kontrole për mbajtjen e saktë të librave bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe për pasojë nuk është vendosur asnjë gjobë në masën 10.000 lekë,siç përcaktohet në nenin 117 të ligjit, nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore”
- nuk ka evidentuar dhe dokumentuar, listën e subjekteve që nuk kanë deklaruar në afat dhe nuk ka asnjë rast të gjobitur në masën 10.000 lekë, në kundërshtim me nenin 113 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore”
- nuk ka nxjerrë njoftimet për pagesën e detyrimeve dhe nuk i është dërguar zyrtarisht Policisë Bashkiake për ndjekje lista e subjekteve debitore .
- nuk i ka kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë të Policisë Bashkisë, për vjeljen e subjekteve debitore, siç parashikohet në nenin 5,shkronja “ç“ nën-pika “i”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”
- nuk u ka dërguar degëve të Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive, për subjekte debitore, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore”
- nuk ka kërkuar që ndaj subjekteve debitore në vlerën përkatëse, vendosjen e barrës siguruese (Drejtorinë Rajonale të Transportit Kukës (për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Bajram Curri (për pasurinë e paluajtshme), kjo bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore”.

3. ■■■ përgjegjës i seksionit të Urbanistikës, në cilësinë e sekretarit të KRRT-së .

4. ■■■ në cilësinë e specialistes së urbanistikës.

Për shkeljet e mëposhtme:

- në dosje mungonin të dhënat e studimit gjeologjike-inxhinerike, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 8402, dt. 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e punimeve”
- në dosje mungonte dokumenti për intensitetin sizmik nga Instituti i Sizmologjisë, në zbatim kjo të detyrës që përcakton ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i cili për fazën e marrjes së lejes së sheshit të ndërtimit, detyron gjithë subjektet private ose publike, për marrjen nga Instituti i Sizmologjisë, të një dokumenti për intensitetin sizmik të sheshit konkret të ndërtimit për të gjitha kategoritë e ndërtesave, pavarësisht nga numri i kateve.

-në dosje mungonin: Kontrata e zbatimit të punimeve me firmën përkatëse, në kundërshtim me nenin 45 dhe 85 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”

-në dosje mungonte deklarata e kufijve (fqinjëve) në kundërshtim me pikën 120/d të Rregullores së Urbanistikës e cila është zbatuar vetëm në rastet e bashkëpronësisë.

-në Formularin e Lejes së ndërtimit, nuk ishte plotësuar afati i Lejes së ndërtimit, në kundërshtim me nenin 44 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”

-nuk janë ushtruar kontrole në drejtim të zbatimit të ligjit të urbanistikës në Bashki dhe për pasojë nuk ka asnjë rast të konstatuar, duke mos zbatuar nenin 28.

- në të gjitha dosjet nuk ishin të **depozituara aktet e kontrollit** që kanë lidhje me akt-kontrollin e përfundimit të themeleve dhe akt-kontrollin e përfundimit të karabinasë, të rifiniturës dhe të sistemimit të ambientit të jashtëm, dhe të konfirmuara nga përfaqësuesit e zyrës së urbanistikës, në kundërshtim të nenit 54 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”

-nga ana e zyrës së urbanistikës, në 25 rastet në periudhën 2009 deri në 6 mujorin e parë 2011 janë pranuar dhe miratuar kërkesa për leje shfrytëzimi, pa u depozituar në dosje dokumentacioni i nevojshëm për të miratuar kërkesën për leje shfrytëzimi, pasi në dosjet e objekteve mungojnë 6 dokumente, në kundërshtim edhe me nenin 9 dhe 11 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

- u konstatua se nga ana e seksionit të urbanistikës ishin pranuar preventiva, pa TVSH, duke shkaktuar **një dëm ekonomik në vlerën 302.324 lekë**, në kundërshtim me udhëzimin e KM nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, kreu i II-të’ “Struktura e kostos së punimeve të ndërtimit”

-deri më datën 08.08.2011 nuk ishin tërhequr 20 leje ndërtimi, të cilave u ka kaluar afati ligjor për dhënien e shesheve dhe lejeve të ndërtimit, ndërkohë nga ana e zyrës së urbanistikës nuk është kërkuar anulimi i tyre, në kundërshtim me nenin 46 dhe 50 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar, ku afatet janë, jo më tepër se 3 muaj për sheshet deri 0.1 ha dhe brenda 45 ditëve, për lejet e ndërtimit.

- në disa raste pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 6 mujorin e dytë të vitit 2009, vitit 2010 dhe 6 mujorit të parë 2011, është bërë në kohën që investitori është pajisur me leje shfrytëzimi, duke u shkelur afatet e tërheqjes së lejeve të ndërtimit, ndërkohë që nga Seksioni i Urbanistikës të Bashkisë Bajram Curri, nuk janë llogaritur kamat vonesat, në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”

-për 64 Lejet e ndërtimit i gjithë dokumentacioni i dosjes, duke filluar nga studimi, projekti, planimetritë, skicat, preventivi dhe mjaft dokumente të tjera, janë hartuar dhe nënshkruar nga Përgjegjësi i zyrës së Urbanistikës [REDAKTUAR], njëherazi edhe sekretar i KRRT-së Bashkisë Bajram Curri, gjë e cila përbën konflikt interesi, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 37”, “Rastet e s’kualifikimit”, pika 1, shkronjat (a), (ç).

5. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor i policisë së bashkisë.

Për shkeljet e mëposhtme:

-nuk ka zbatuar kërkesat e urdhrat të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003” dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës” dhe konkretisht:

a)-nuk janë zbatuar rregullat standart në kryerjen e detyrave, përcaktuar në Kreun VII-të, **pasi nuk është hartuar**, plani i vendosjes në shërbim, parashikuar në nenin 20, regjistri i shërbimit, parashikuar në nenin 21 dhe raporti i shërbimit, parashikuar në nenin 22.

b)-për mos vendosje të asnjë gjobe për 2 vitet 2009 - 2010 në mbështetje të nenit 8 dhe 13 të ligjit, nr.8224,datë 15.5.1997,ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”,

c)-për mos njohje të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e policisë dhe konkretisht ligjin nr.8224,datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” dhe urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530 datë 07.04.2003” dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të komunës”,duke shkelur kështu nenin 4 “Detyrim ndaj ligjit”, të Rregullores të cituar më sipër.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Halil Isufi, Besim Bileri, Niko Nako dhe ing. Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT